

Shega Trans Sh.a.

**Pasqyrat financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
me raportin e audituesit të pavarur**

Përmbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	4
1. Informacion i përgjithshëm.....	5
2. Bazat e përgatitjes.....	5
3. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet kontabël të rëndësishme	7
4. Politika të rëndësishme kontabël	8
5. Adoptimi i SNRF për herë të parë	12
6. Standarte të publikuara por ende të pazbatuara.....	16
7. Aktivet afatgjata materiale	17
8. Investime deri ne maturim	18
9. Te tjera te drejta per tu arketuar.....	18
10. Garanci te dhena te treteve	18
11. Të tjera te drejta të arketueshme	18
12. Llogari te arketueshme.....	19
13. Inventari.....	19
14. Mjete monetare dhe të ngjashme	19
15. Kapitali.....	20
16. Huatë me institucionet financiare	20
17. Llogari të pagueshme dhe te tjera.....	20
18. Detyrime ndaj punonjesve	21
19. Te tjera detyrime.....	21
20. Detyrime tatimore dhe të tjera.....	21
21. Te ardhurat	21
22. Shpenzimet e personelit.....	22
23. Shpenzime per taksa te ndryshme	22
24. Shpenzime mirembajtje dhe riparimi.....	22
25. Shpenzime te tjera operative.....	22
26. Qera, uje dhe energji.....	23
27. Shpenzime financiare	23
28. (Humbje)/Fitim nga kursi i këmbimit, neto	23
29. Shpenzime tatim fitimi	23
30. Menaxhimi i Rrezikut Financiar.....	23
31. Angazhime dhe kushtëzime.....	26
32. Ngjarjet pas datës së raportimit.....	27

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin dhe aksionarët e,

Shega Trans SH.A.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Shega Trans Sh.a. (më poshtë “Shoqëria”) që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2013, pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe informacione të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e drejtimin për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimit apo gabimeve.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tonë në pajtim me Standardet Nderkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikes dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të pasaktësive materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë të kualifikuar.

TPA Horwath Albania

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 10 000 Tirana, Albania
www.tpa-horwath.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia
Member of Crowe Horwath International (Zürich) – a worldwide association of separate and legally independent chartered accountants and consultants

Bazat për Opinionin e Kualifikuar

Siç është paraqitur në Shënimin 9 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlera e te tjera te drejtave per tu arketuar është 57.888.940 Leke. Kjo vlere mbartet per me shume se 3 vite radhazi pa pasur levizje dhe ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë e kësaj shumë si dhe drejtimi nuk ka paraqitur ndonje evidence te mjaftueshme per mbledhshmerine e ketyre shumave.

Siç është paraqitur në Shënimin 10 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlera e te tjera te drejtave per tu arketuar është 1.079.500 Leke. Kjo vlere mbartet per me shume se 3 vite radhazi pa pasur levizje dhe ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë e kësaj shumë si dhe drejtimi nuk ka paraqitur ndonje evidence te mjaftueshme per mbledhshmerine e ketyre shumave.

Siç është paraqitur në Shënimin 11 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlera e te tjera te drejtave është 11.779.819 Leke. Ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë e kësaj shumë si dhe drejtimi nuk ka paraqitur ndonje evidence te mjaftueshme per mbledhshmerine e ketyre shumave.

Siç është paraqitur në Shënimin 11 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlerat e te drejtave ndaj punonjesve është 25.314.907 Lekë. Ne kete shume ka nje vlere prej 18.302.416 Lekë që martet për më shumë se një vit dhe ne nuk ishim në gjendje të merrin konfirmime nga palët e treta në lidhje plotësinë dhe saktësinë si dhe drejtimi nuk ka paraqitur ndonje evidence te mjaftueshme per mbledhshmerine e ketyre shumave.

Siç është paraqitur në Shënimin 13 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlera e inventarit është 19.837.773 Lekë. Ne nuk kemi vëzhguar inventarizimin fizik të inventarit më 31 Dhjetor 2013 meqenëse kjo datë ka qenë para se ne të angazhoheshim si auditues të shoqërisë dhe per shkak te natyres se biznesit nuk ishim ne gjendje qe me menyra alternative te siguronim evidence te mjaftueshme per te konfirmuar vleren e inventarit gjendje me 31 Dhjetor 2013.

Opinion i Kualifikuar (me rezerve)


Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të cështjeve së diskutuara në paragrafin “Bazat për Opinionin e Kualifikuar”, pasqyrat financiare të Shega Trans Sh.a. paraqesin në mënyrë të sigurtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2013, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë dhe ndryshimet në kapital, në përputhje me Standartet Nderkombetare të Raportimit Financiar.


Cështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2012 janë audituar nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar për këto pasqyra.

Tirana,

30 Qershor 2014


TPA Horwath Albania sh.p.k



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 Dhjetor 2013

		<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>1 Janar 2012</u>
	Shënime	në Lekë	në Lekë	në Lekë
Aktive				
Aktive afatgjata				
Aktivitet afatgjata materiale	7	761.263.391	392.919.516	246.405.939
Investime deri ne maturim	8	67.900.000	0	0
Te tjera te drejta per tu arketuar	9	57.888.940	57.888.940	57.888.940
Garanci te dhena te treteve	10	1.079.500	1.079.500	1.079.500
Total - Aktive afatgjata		888.131.831	451.887.957	305.374.380
Të tjera te drejta te arketueshme	11	250.701.254	343.762.990	248.757.040
Llogari te arketueshme	12	199.006.647	198.456.858	176.845.886
Inventari	13	19.837.773	14.370.393	11.161.604
Mjete monetare dhe të ngjashme	14	4.403.200	4.452.801	4.639.316
Total – Aktive afatshkurtra		473.948.874	561.043.043	441.403.846
TOTAL AKTIVE		1.362.080.706	1.012.930.999	746.778.226
Kapitali dhe Detyrimet				
Kapitali aksionar		104.097.655	104.097.655	59.079.352
Rezerva ligjore		8.481.707	8.481.707	4.002.362
Fitimi i pashperndare		145.060.910	81.982.566	190.500.655
Total – Kapitali	15	257.640.272	194.561.928	253.582.369
Detyrime afatgjata				
Huatë nga institucionet financiare	16	421.228.761	170.530.703	89.872.513
Total - Detyrime afatgjata		421.228.761	170.530.703	89.872.513
Detyrime afatshkurtra				
Llogari te pagueshme dhe te tjera	17	232.101.291	291.512.940	213.932.593
Huatë nga institucionet financiare	16	403.569.832	310.681.523	179.055.423
Detyrime ndaj punonjesve	18	19.291.788	10.086.105	7.222.397
Te tjera detyrime	19	18.532.341	28.793.515	0
Detyrime tatimore	20	9.716.422	6.764.286	3.112.931
Total - Detyrime afatshkurtra		683.211.673	647.838.369	403.323.344
Total - Detyrime		1.104.440.434	818.369.072	493.195.857
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET		1.362.080.706	1.012.930.999	746.778.226

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese nga 1 deri në 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, janë autorizuar nga drejtimi më 28 Mars 2014 dhe nëshkruar në emër të tij nga:

Administrator

Artur Kociaj



Drejtor Finance

Albana Lushaj

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

Shënime	Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2013 në Lekë	Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2012 në Lekë
Të ardhura nga operacionet	1.588.079.070	1.460.943.795
Të ardhura të tjera	14.471.198	28.088.750
Total të ardhura	21 1.602.550.268	1.489.032.546
Blerje karburanti	(360.132.731)	(260.954.307)
Shpenzime spedicioni	(337.517.436)	(614.655.016)
Shpenzime për personelin	22 (308.880.427)	(161.391.424)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	7 (124.317.753)	(84.227.235)
Shpenzime për taksa të ndryshme	23 (99.533.997)	(88.207.810)
Shpenzime mirëmbajtje e riparimi	24 (92.560.111)	(62.820.730)
Shpenzime të tjera operative	25 (71.709.715)	(113.269.821)
Qera, uje , energji	26 (59.395.400)	(30.550.997)
Fitimi operacional	148.502.698	72.955.206
Shpenzime financiare	27 (66.163.337)	(41.319.486)
(Humbje)/Fitim nga kursi i këmbimit, neto	28 (9.435.682)	(2.940.459)
Të ardhura financiare	0	188.109)
Fitimi para tatimit	72.903.680	28.883.370
Tatimi mbi fitimi	29 (9.825.336)	(5.567.335)
(Humbja)/Fitimi neto për vitin	63.078.344	23.316.036
Të ardhura të tjera përmbledhëse	0	0
(Humbja)/Fitimi përmbledhës për vitin	63.078.344	23.316.036

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shega Trans SH.A.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL****Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**

	Kapital aksionar	Rezervat	Fitimi i	Totali
	në Lekë	statutore/ligjore	pashperndare	në Lekë
	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë
Gjendja më 1 Janar 2012	59.079.625	4.002.362	190.500.383	253.582.370
Fitimi i vitit	0	0	23.316.036	23.316.036
Të ardhura të tjera përmbledhëse	0	0	0	0
Totali i të ardhurave përmbledhëse	0	0	23.316.036	23.316.036
Korigjim rezultati	0	0	(26.440.759)	(26.440.759)
Emetimi i kapitalit aksionar	45.018.030	0	(45.018.030)	0
Transferimi ne rezerven ligjore	0	4.479.345	(4.479.345)	0
Dividente te paguar			(55.895.718)	(55.895.718)
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	104.097.655	8.481.707	81.982.567	194.561.929
Fitimi i vitit	0	0	63.078.344	63.078.344
Të ardhura të tjera përmbledhëse	0	0	0	0
Totali i të ardhurave përmbledhëse	0	0	63.078.344	63.078.344
Shperndarja e fitimit	0	0	0	0
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	104.097.655	8.481.707	145.060.910	257.640.272

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHEGA TRANS SH.A.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË****Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**

		Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2013 në Lekë	Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2012 në Lekë
Aktivitetet operative			
Të ardhurat pas tatimit		63.078.343	23.316.036
Korrigjime mbi humbjen neto për të përfituar flukset monetare nga aktiviteti operativ:		-	
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7	124.317.753	77.729.990
Rimarrje amortizimi per aktivet e shitura	7	(4.631.160)	(6.497.248)
Shpenzime (të ardhura) nga interesat neto		66.163.337	41.319.485
Rregullimet e kapitalit punues		-	
(Rritje)/Zvogëlim në të drejta ndaj klienteve		(549.789)	(21.610.972)
(Rritje)/Zvogëlim në të tjera te drejta te arketueshme		93.061.736	(95.005.950)
(Rritje)/Zvogëlim në inventar		(5.467.380)	(3.208.789)
Rritje/(Zvogëlim) në llogari të pagueshme dhe te tjera		(59.411.648)	77.580.347
Rritje/(Zvogëlim) në detyrime të tjera		1.896.646	35.308.578
Interesi neto (i paguar)		(66.163.337)	(41.319.485)
Mjetet monetare neto të (përdorura)/përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit		(212.294.500)	87.611.991
Aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve, neto nga shitja	7	(488.030.467)	(64.369.232)
Rregullime te gabimeve te viteve te meparshme			(153.377.087)
Investime ne shoqeri te lidhura		(67.900.000)	0
Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(555.930.467)	(217.746.319)
Aktivitetet financuese			
Të hyra nga huamarrjet		512.269.349	353.489.846
Parapagesa e huamarrjeve		(168.682.983)	(141.205.555)
Rregullime te viteve te kaluara		0	(26.440.759)
Pagese dividenti		0	(55.895.718)
Mjetet monetare neto të përfituara në aktivitetet financiare		343.586.366	129.947.814
Pakesimi neto i mjeteve monetare		(49.601)	(186.515)
Mjete monetare në fillim të periudhës		4.452.801	4.639.316
Mjete monetare në fund të periudhës		4.403.200	4.452.801

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Shega Trans Sh.A (e quajtur më tej “Shoqëria”) është një shoqëri aksionere transporti regjistruar ne Regjistrin Tregtar ne Tirane, date 13.01.2005 me vendim te Gjykates se Tiranes dhe ka NIPT K51504004P, regjistruar ne QKR me seli qendrore Tirane Rruga Ali Kelmendi, ish Kombinati i Tekstileve.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë konsiston ne Transport nderkombetar mallrash, agjensi detare, agjensi spedicionere etj, Transport kombetar dhe nderkombetar te pasagjereve per te trete dhe per nevoja te vet shoqërisë, Agjensi per shitje biletash transporti nderkombetar dhe brenda vendit te udhetareve. Transport te udhetareve ne linja urbane dhe interurbane.

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lekë shqiptar (“Lekë”), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria (shiko gjithashtu shënimin 3.a).

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t’i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t’i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me ato të vitit financiar të kaluar, pervec SNRF e mëposhtme të reja dhe të amenduara dhe interpretimet e KIFRN të vlefshme nga 1 Janar 2013:

- **SNK 1 Prezantimi i pasqyrave financiare (e korigjuar) – Prezantimi i zerave te te ardhurave gjithë përmbledhese.**
- **SNK 19 Perfitimet e punonjesve (e rishikuar)**
- **SNRF 7 Instrumentat Financiare: Dhënia e informacione shpjeguese (e korigjuar) – Kompensimi i aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare**
- **SNRF 13 Matja me vleren e drejte**
- **KIFRN 20 Kostot e nxjerrjes, ne fazen e prodhimit te siperfaqes se minierave**
- **Permiresimet vjetore te SNRF per ciklin – 2009 – 2011**
- **SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale” (rishikuar më 2011) (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2013),**
- **SNRF 7 “Instrumentat financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese” (e rishikuar) - Transferimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2013),**
- **SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2013),**
- **SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta” (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2013),**
- **SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera” (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2013),**
- **SNRF 13 “Matja e vlerës së drejtë” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2013),**

Adoptimi i standardeve ose interpretimeve është përshkruar si më poshtë:

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

• **SNK 1 Prezntimi I pasqyrave financiare (Rishikuar) – Prezantimi i zerave te te ardhurave gjithë permledhese**

Rishikimi i SNK 1 ndryshon grupimin e zerave te paraqitur ne Te ardhurat gjithë permbledhese. Zerat qe mund te riklasifikohen (ose 'riciklohen') ne fitim ose humbje ne nje date te caktuar ne te ardhmen (p.sh, fitimi neto nga mbrojtja e nje investimi neto, diferencat e kurseve te kembimit nga perkthimi I operacioneve te huaja, levizja neto ne mrotjejn qe u behet flukseve te parase si dhe fitimi apo humbja neto nga aktivet financiare te mbajtura per shitje) duhet te pasqyrohen vecante nga zerat qe nuk riklasifikohen kurre (p.sh, fitimet/humbjet aktuariale mbi planet e kontributeve te percaktuara dhe rivleresimi I aktiveve afatgjata materiale). Rishikimi ndikon vetem prezantimin dhe nuk ka ndikim mbi pasqyren financiare apo performance e shoqerise. Ky standart nuk ka ndonje efekt mbi shoqerine.

• **SNK 19 Perfitimet e punonjesve (Rishikuar)**

SNK 19 ka nje numer rishikimesh persa I perket kontabilizimit per planet e perfitimeve te percaktuara, duke perfshire ketu fitimet dhe humbjet te cilat njihen tashme ne te ardhurat gjithëpermbledhese dhe qe jane te menjauara totalisht nga fitimi dhe humbja; te hyrat e pritura nga aktivet e planit te cilat nuk njihen me ne fitim apo humbje, ne te kundert, ka nje kerkese qe te njihet interes mbi detyrimin (aktivin) neto te planit te perfitimeve te percaktuara, i perlllogaritur duke perdorur normen e skontimit per te matur detyrimin e perfitimeve te percaktuara, dhe; kostot e sherbimeve te kaluara qe nuk humbasin njihen tashme ne fitim ose humbje ne daten me te afert qe ka ndodhur rishikimi apo kur jane njohur kostot e perfundimit apo ristrukturimit. Te tjera rishikime perfshijne shenime te tjera shpjeguese, te tilla si, shenime shpjeguese persa i perket ndjeshmerise sasiore. Ky rishikim nuk ka efekt mbi shoqerine.

• **SNK 28 “Investime në filial dhe shoqëri të përbashkëta” (rishikuar më 2011) (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2013),**

Si pasoje e SNRF te reja si 11 Marreveshjet e perbashketa dhe SNRF 12 Shpalosjet e interest ne Entitetet e tjera, SNK 28 Investime ne filial, eshte riemrtuar SNK 28 Investime ne filial dhe Siper marrje te perbashketa, dhe pershkruan aplikimin e metodese se kapitalit per investimet ne siper marrjet e perbashketa perkrah filialeve. Ky rishikim nuk ka efekt mbi shoqerine

• **SNRF 7 Instrumentat financiare: Shenime shpjeguese (rishikuar) – Kompensimi I aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare**

Ky rishikim kerkon qe nje shoqeri te jape shenime shpjeguese persa i perket te drejtes per te kompensuar si dhe angazhimeve te lidhura (p.sh. marreveshjet e kolateralit). Qasja do u jape perdoruesve informacion i cili eshte i nevojshem per te vleresuar ndikimin e marreveshjes se kompensimit mbi pasqyren e pozicionit financiar te shoqerise. Shenimet shpjeguese te reja duhen per te gjithë instrumentat financiare te njohura te cilat kompensohen ne perputhje me SNK 32 Instrumentat financiare: Prezantimi. Shenimet shpjeguese aplikohen gjithashtu per instrumentat financiare te njohur qe jane subjekt i nje marreveshje kompensimi kryesore te detyrueshme ose nje marreveshje te ngjashme, pavaresisht nese ato jane kompensuar ne perputhje me SNK 32. Ky rishikim nuk ka efekt mbi shoqerine

• **SNRF 13 Matja e vleres se drejte**

SNRF 13 percakon nje burim te vetem udheheqjeje sipas SNRF-ve per te gjitha matjet e vleres se drejte. SNRF 13 nuk ndryshon kur nje shoqeri eshte e detyruar te perdore vleren e drejte, por me shume jep udheheqje se si te matet vlera e drejte sipas SNRF kur vlera e drejte kerkohet apo lejohet. Aplikimi I SNRF 13 nuk ka ndikim te rendesishem mbi matjet e vleres se drejte te aplikuar nga shoqeria. SNRF 13 kerkon gjithashtu qe te shpalosen disa informacione mbi vlerat e drejta, disa prej te cilave zevendesojne kerkesat ekzistuese per shpalosjen e informacionit ne standarte te tjera, duke perfshire SNRF 7 Instrumentat financiare: Shpalosjet. Ky standart nuk ka efekt mbi shoqerine.

• **KIFRN 20 Kostot e nxjerrjes, ne fazen e prodhimit te siperfaqes se minierave**

Ky interpretim aplikohet mbi heqjen e mbeturinave (kostot e nxjerrjes) te hasura ne aktivitetet e sipefaqeve minerare, gjate fazes se prodhimit te minierave. Interpretimi adreson kontabilizimin per perfitimet e aktivitetit te nxjerrjes. Ky interpretim nuk ka ndikim mbi shoqerine.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

- **BSNK ka nxjerre permiresimet vjetore te SNRF-ve Cikli – 2009 – 2011**, qe perfshijne rishikime te standarteve te tij dhe bazen respektive per konkluzionet. Projekti I permiresimeve vjetore jep nje mekanizem qe ben te mundur, por jo urgjente, rishikimet e SNRF. Keto permiresime nuk kane ndonje ndikim mbi shoqerine.
 - **SNRF I Adoptimi per here te pare I SNRF:** Ky permiresim sqaron qe nje shoqeri qe ka ndaluar se perdoruri SNRF ne te kaluaren dhe zgjedj, apo detyrohet te perdore SNRF, ka opsionin te ri-perdore SNRF 1. Nese SNRF 1 nuk ri-aplikohet, shoqeria duhet te riparaqese pasqyrat e saj financiare ne menyre retrospective sikur te mos kishte ndaluar ndonjehre se aplikuari SNRF.
 - **SNK 1 Prezantimi i pasqyrave financiare:** Ky permiresim sqaron diferencen ndermjet informacionit shtese krahasues ne menyre vullnetare dhe minimumit te informacionit krahasues te kerkuar. Pergjithesisht, minimumi i periudhes krahasuese te kerkuar eshte periudha paraardhese.
 - **SNK 16 Aktivet afatgjata materiale:** Ky permiresim sqaron qe pjeset e nderrimit kryesore dhe mjeteve te sherbimit qe plotesojne perkufizimin e aktiveve afatgjata material, nuk jane inventar.
 - **SNK 32 Instrumentat financiare, Prezantimi:** Ky permiresim sqaron qe tatim fitimi qe rezulton nga shperndarja e mbajtesve te kapitalit kontabilizohet ne perputhje me SNK 12 Tatimi mbi fitimin.
 - **SNK 34 Raportimi financiar i ndermjetem:** Ky permiresim lidh kerkesat e shpalosjes per aktivet segmentale totale me detyrimet degmentale totale ne pasqyrat financiare te ndemjetme. Ky sqarim siguron gjithashtu qe shpalosjet e ndermjetme jane ne koherence me shpalosjet vjetore.

3. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet kontabël të rëndësishme

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit mbi fitimin të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njihet detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar nga Shoqëria në mënyrë konsistenete për të gjithë periudhën të paraqitur në pasqyrat financiare.

(a) Transksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

(b) Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlere neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshin para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë nga Institucionet Financiare

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skonton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër..

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Të tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve afatgjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot në vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitetit afatgjatë material regjistrohen me vlerën kontabël të aktivitetit në rast të është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërtuara si rrjedhojë ç'rrregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve regjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitetit ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur për paisjet e zyrës me një normë amortizimi vjetore prej 20%, për paisjet informatike 25% dhe për makinat e transportit 20%. Kjo mënyrë pasqyron më përafërsis trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Përmirësimet e aktiveve të marra me qera amortizohen me 20%. Aktivet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(d) Aktivet afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

Kostot në vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktiviteti specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një normë vjetore amortizimi 25% për paisje kompjuterike.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Rënia në vlerë

Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktiviteti të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitetet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivitetet jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skantohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësive të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(f) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

(g) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(h) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimëve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

Të ardhurat nga operacionet

Të ardhurat e shoqërisë perbehen kryesisht nga shërbimi i transportit, speditimit si dhe të ardhurat e tjera të tilla si, të ardhura nga qeraja etj.

(i) Pagesat e qerasë

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(k) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(m) Shpenzime për tatim fitimin

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. Adoptimi i SNRF për herë të parë

Këto pasqyra financiare, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2013, janë përgatitur për herë të parë në përputhje me SNRF nga Shoqëria. Për periudhën deri më, përfshirë dhe vitin që përfundon, në 31 Dhjetor 2012 Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me parimet kontabël përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit lokal (Standartet Kombëtare të Kontabilitetit).

